

nr./titull: 01-593
data: 12.11.2019

NOVOBËRDË - NOVO BRDO



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e njëmbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më **18.11.2019** (e hënë) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
1. Propozim plani Aksional për të riatdhësuarit;
2. Propozim plani Aksional për Kthim të qëndrueshëm;
2. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:12.11.2019
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

21. Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.10.2019, duke filluar në orën 10:15. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhui, Drejtori i Financave Sercan Todorovic.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për tremujorin e tretë;
3. Të ndryshme.

Kryesusi tha: a keni ndonjë propozim apo pajtoheni me këtë rend dite?

Xhejlane Behluli pasi përshëndeti të pranishmit tha: i kam dy propozime për Kuvend nese më perkrahni, dy kërkesa për raportim kerkoj që ti kemi nga Drejtoria për sherbime publike, njëra ka të bëjë me fshatin Starishor ku pas shumë kërkesave që kanë parashtrua në këtë Drejtori të protokoluara nuk kanë marrë asnjë përgjigje, kërkesa tjetër ka të bëjë me investimet që janë bërë në rrugë në fshatin Pasjak dhe kompanit e kontraktuara kerkojm ta dijm se a janë riparuar ato shakta dhe të njejtën kohë rrugët që janë asfaltu të reja Komuna me marrë përgjegjësi me i rregullu shaktat. Kërkesa tjetër ka të bëjë me Drejtorinë e Arsimit, në mandatin e Bajrush Ymerit sa ka qenë Kryetar ka pas bursa për nxënës tani nuk ka andaj kerkoj një raport për mënyres se si ka funksionu bursat në kohen e Bajrush Ymerit pse nuk po funksionon tash?. Pikat mundemi bashkarisht ti formulojm nese më perkrahni, ju faleminderit.

Kryesusi tha: kush është për që propozimet e Xhejlane Behluli të shkojnë në Kuvend?

Aprovohen njëzëri nga antarët e KPF-së këto propozime që të shkojnë në Kuvend.

Mirjana Simijonovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: probelmi në Koretishtë është lidhur me ujësjellësin, në fshat e kemi pasur një shpim të burimit të ujit i cili ka funksionuar dhe na ka furnizuar me ujë Koretishten si dhe një pjesë të Pasjakit mirëpo para një viti Komuna më Memorandum ja ka kaluar Hidromoraves në menaxhim, rreth asaj marrëveshje kerkoj që të vij dikush ose nga zyra e Kryetarit ose nga Drejtoria e Sherbimeve Publike që të vij në Kuvend dhe të raportoj se si do të funksionoj ajo marrëveshje në mes të Komunës dhe Hidromoraves. Uji me atë burim a do të kyçet në Gjilan të shkoj njëher në Gjilan pastaj të vij te ne apo si e kan menduar at marrëveshje, dhe ka qenë Kryetari dhe na ka thënë se gjysma e borxhit është paguar dhe tash na intereson se a është paguar ai borgj apo jo?, pasi që Hirdomorava ka thënë se pa u paguar ai borgj ne nuk e lshojm pompen, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: kush është që propozimi i Mirjanes të shkoj në Kuvend?

Aprovohen njëzëri këto propozime nga antarët e KPF-së që të shkojnë në Kuvend.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam edhe unë një propozim për rend dite për Kuvend, që 10 ditë nxënësit në të gjithë Komunën e Novobërdës janë pa transport andaj kerkoj një raport nga Drejtoria e Arsimit lidhur me këtë qështje, ka nxënës që disa ditë që nuk e vijnë mësimin fare për neglizhenc të zyrtarëve Komunal pasi që nuk kanë shpallur tenderin me kohë, ju faleminderit.

Kryesusi tha: propozimin e Selatinit do ta fomulojm me një pikë për ndarje të bursave pasi që kanë të bëjnë me të njejtën Drejtori.

Drejtori i Financave Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: ju të gjith po propozoni pika për rend dite por unë do të kerkoj terheqjen e pikës së dytë nga rendi i ditës për arsye se nuk kam pasur mundësi që ta pregadi se kam qenë i sëmur si dhe zyratri i cili e pregadi këtë raport gjendet në pushim mjeksorë andaj kerkoj që të shtyhet ky raportim tremujor financiar për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. E kam edhe një propozim për rend dite që të shkoj në Kuvend, na duhet një vendim i Kuvendit për bartje të mjeteve nga zyrja e Kryetarit nga mallra dhe shërbime në shërbime Komunale, Kuvendi ka të drejt nga shuma momental 15% ti bartim cilit do shërbim tjetër Komunal dhe këto mjete na duhen pikërisht për për pagesa të rrymës së ujësjellsave si dhe pagesa të rrymes në shkolla dhe ambulanta.

Kryesuesi tha: kush është që propozimi i Drejtorit të Financave të shkoj në Kuvend?
Aprovohen njëzëri këto propozime nga antarët e KPF-së që të shkoj në Kuvend.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali aprovohet me 4 vota për dhe 1 apstenim nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi i Raportit Financiar për tremujorin e tretë;

Kryesusi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Finncave.

Sercan Todorovic tha: siç e ceka edhe më heret për arsye shëndetsore nuk kemi psur mundësi që ta pregadisim këtë raport andaj kerkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Selatin Nuhiu tha: më vjen keq prej Drejtorit që ka pasur probleme shëndetsore, mendoj se nuk janë vetem dy persona që e pregadisnin këtë raport tremujorësh, është afati ligjor që ne duhet ta aprovojm këtë raport.

Xhejlane Behluli tha: pasi që është veq raport nuk mundemi me ndryshu ose me intervenu, është veq raport nuk është propozim, nuk jam duke e perkrah se është Drejtor dhe është nga egzekutivi por është vetem raport e votuam apo se votuam.

Sercan Todorovic tha: ta njoftoj Selatini se çdo zyrtarë i ka punët e veta, e kemi zyrtarin për paga, e kemi zyratrin e të hyrave dhe zyrtarin e të dalave.

Selatin Nuhiu tha: unë mendoj se nuk është asnjë herë serioz ndaj Kuvendit, çdo herë është vonuar në raporte tremujore, nuk ka sjell raporte gjashtmuajore dhe vjetore.

Sercan Todorovic tha: ai që e respekton Kuvendin më së shumti jamë unë, asnjë herë në asnjë pikë nuk jam vonuar dhe çdo herë ju kam sjell pika për rend ditë.

Kryesusi tha: pasi që propozuesi i kësaj pike kerkon terheqjen e kësaj pike konstatojm e kjo pikë terhiqet dhe shtyhet për një nga mbledhjet e ardhshme.

Pika e tretë: Të ndryshme.


Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic pasi pershendeti tha: është e vertet se në kohen e Bajrushit ka pasur Bursa po është e vertet edhe se në vitin e parë të Svetislav Ivanovicit ka pasur bursa, e prej viti të dyt e kendej nuk ka pasur.


Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic



Procesverbali i KPF-së